




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TE 7
Leonard Kërquki
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2022/7 - Mërgim Teplani (Palë ankuese) kundër TE 7 (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM ka pranuar një Ankesë të parashtruar nga z. Mërgim Teplani (Palë ankuese, përfaqësues i kolektivit të gjimnazit Eqrem Çabej në Prishtinë), ku theksohet se: "Ne kolektivi i gjimnazit Eqrem Çabej në Prishtinë ndihemi tejet të ofenduar ndaj kronikës së emetuar në lajmet qendrore të orës 19:30 të datës 10.02.2022 në mediumin T7. Në kronikën e emetuar nga mediumi në fjalë lëshohet kjo deklaratë: "Drejtori i shkollës z. Shemsedin Beqiri nuk u deklarua, por nuk lejoi as stafin të flasë mbi këtë problem." Kjo deklaratë nuk është aspak e vërtetë, është kundër etikës së gazetarisë. Ne asnjëherë nuk jemi detyruar nga drejtori i shkollës të mos prononcohemi për këtë medium."
3. Më datën 2 mars 2022 Pala ankuese e ka njoftuar KPM-në se i është drejtuar mediumit me të njëjtën Ankesë me datën 22 shkurt 2022. Sipas Palës ankuese edhe përkundër afatit ligjor prej shtatë (7) ditësh, Pala përgjegjëse nuk i është përgjigjur Ankesës dhe nuk i ka ofruar të drejtën e reagimit z. Teplani.
4. KPM me datën 3 mars 2022, me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore të Palës ankuese, ka kërkuar nga Pala përgjegjëse që brenda tre (3) ditësh të sjellë sqarim lidhur me Ankesën në fjalë.
5. Pala përgjegjëse me datën 3 mars 2022 i është përgjigjur kërkesës së KPM-së, përmes së cilës theksohet se: "Televizioni 7 ka realizuar një storje për mungesën e peletit në shkollën "Eqrem Çabej", ku ka biseduar me nxënës që janë ankuar e më pas ka kërkuar një përgjigje nga drejtori i shkollës Shemsedin Beqiri. Ai nuk ka pranuar të flasë e më pas gazetarja ka tentuar të bisedojë me koordinatoren e shkollës por drejtori nuk e ka lejuar."

Dhe krejt kjo situatë është përmbledhur me një fjalë: "drejtori Beqiri nuk u deklarua por as nuk lejoi as stafin të flasin për këtë problem." Nëse kjo është shkelja, atëherë me lejoni të shpreh keqardhje për nivelin e profesionalizmit të KPM-së. Por më shumë se mungesë profesionalizmi nga ana e KMP-së unë shoh një tendencë të zyrtarëve të caktuar të Komisionit të Pavarur për Media ndaj Televizionit 7."

6. KPM, me qëllim të vlerësimit të Ankesës së Palës ankuese, në bazë të Raportit të monitorimit të datës 4 mars 2022 ka gjetur se Pala përgjegjëse nuk i ka ofruar të drejtën për reagim Palës ankuese, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2 të, Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
7. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 10 mars 2022 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe e ka udhëzuar që në afat brenda shtatë (7) ditëve, nga pranimi i shkresës, t'i ofrojë të drejtën e reagimit Palës ankuese, siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03.
8. Pala përgjegjëse me datë 15 mars 2022 i është përgjigjur Njoftimit për Shkelje duke deponuar edhe një audio në të cilën është incizuar biseda mes gazetares së televizionit dhe drejtorit të shkollës, në të cilën bisedë ndër të tjera gazetarja thotë se: *"KPM na ka thënë që ta vazhdojmë storien."*
9. Për të vërtetuar se Pala përgjegjëse i ka ofruar të drejtën e reagimit Palës ankuese, KPM ka bërë sërish monitorim dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 18 mars 2022, ka gjetur se Pala përgjegjëse nuk i ka ofruar të drejtën për reagim Palës ankuese, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Analiza ligjore

10. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
11. KPM, me qëllim të vlerësimit të Ankesës së Palës ankuese bazuar në Raportin e monitorimit të datës 4 mars 2022, ka gjetur se Pala ankuese e ka njoftuar KPM-në se i është drejtuar mediumit me të njëjtën Ankesë më datën 22 shkurt 2022 dhe se edhe përkundër afatit ligjor prej shtatë (7) ditësh, Pala përgjegjëse nuk i është përgjigjur ankesës dhe nuk i ka ofruar të drejtën për reagim Palës ankuese. Në lidhje me këtë KPM i ka dërguar kërkesë për sqarim Palës përgjegjëse, ka pranuar Përgjigje prej tyre dhe pas analizimit të saj ka arritur në përfundim se kur Pala ankuese pretendon se faktet të cilat janë bërë të disponueshme për publikun e të cilat ai i deklaroi që janë të pasakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korrigjuar faktet që e shqetësojnë atë person. Pala përgjegjëse duke mos ia ofruar të drejtën për reagim Palës ankuese ka vepruar në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një ofrues të shërbimit medial për të cilin faktet janë bërë të disponueshme për publikun të cilat ai i deklaron që janë të pa sakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korrigjuar faktet që shqetësojnë atë person.”

12. KPM me datën 10 mars 2022 i ka dërguar Njoftim për shkelje TE 7 për shkak se nuk i ka ofruar të drejtën për reagim Palës ankuese dhe në Përgjigjen e kthyer ndaj Njoftimit për shkelje Pala përgjegjëse ka bashkëngjitur një audio në të cilën është incizuar biseda mes një gazetareje të televizionit dhe drejtorit të shkollës, në të cilën bisedë ndër të tjera gazetarja thotë se: *“KPM na ka thënë që ta vazhdojmë storien.”* KPM përmes Njoftimit për shkelje nuk ka kërkuar nga Pala përgjegjëse që ta vazhdojë storien, por e ka udhëzuar që t’ia ofrojë të drejtën e reagimit Palës ankuese në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. Pavarësisht udhëzimit të KPM-së Pala përgjegjëse ka dështuar t’ia ofrojë të drejtën e reagimit Palës ankuese.

13. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit të datës 18 mars 2022, ka gjetur se Pala përgjegjëse edhe pas udhëzimit nga KPM që në afat brenda shtatë (7) ditëve, t’i ofrojë të drejtën e reagimit Palës ankuese nuk e ka transmetuar reagimin, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Me qëllim korrektësisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë.”

14. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse me mos transmetimin e reagimit të Palës ankuese, respektivisht mos dhënien e drejtës për reagim ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim


15. Pala përgjegjëse sanksionohet me **Vërejtje** në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

16. Obligohet Pala përgjegjëse që në afat prej shtatë (7) ditësh, pas pranimit të këtij Vendimi, t’i ofrojë Palës ankuese të drejtën e reagimit, siç përcaktohet në nenin 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

17. Në rast se Pala përgjegjëse edhe pas pranimit të këtij Vendimi nuk ia ofron të drejtën e reagimit Palës Ankuese, Komisioni do të ndërmarrë masa tjera sanksionuese ndaj Palës përgjegjëse në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për ankesë

18. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
19. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Xhevat Latifi
Kryetar



5.4.2022
Datë